



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM,

Data: 09.07.2024, Nr. 09-610/01-32365



Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtori i Drejtorisë për Arsim, shpallë:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " GJERGJ K ASTRIOTI -SKËNDËRBEU" DHE NË IAAP " FEHMI LLADROVCI " NË DRENAS PËR VITIN SHKOLLOR 2024/2025

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025, ka përgatitur "Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e (10) në Gjymnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP)".

MASHTI ka përcaktuar afatet për publikimin e konkursit dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në 1<1. 10, në Gjymnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP).

Konkursi do të publikohet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në komunat përkatëse.

Obligimet e DKA dhe MASHTI:

- Planifikimi duhet të dorëzohet në MASHTI për të dy afatet (konkursi për afatin e parë dhe të dytë).
- Kërkesat për drejtime dhe profile të reja duhet të bëhen në MASHTI (në departamentet përkatëse).

-DKA-të të formojnë komisionet profesionale dhe përkatëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X).

-MASHTI do të bëjë monitorimin e procesit të regjistrimit dhe pranimit të nxënësve.

Kriteret dhe kushtet për regjistrim për vitin shkollor 2024-2025:

- Dorëzimi i dokumenteve më 10, 11 dhe 12 korrik 2024
- Shpallje e rezultateve më 13.07.2024
- Shpallja e konkursit plotësues në muajin gusht për vendet e lira më datë 19. 08. 2024
- Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues më datë 19, 20 dhe 21 gusht 2024,
- Shpallje e rezultateve për konkurs plotësues më 22.08.2024

Konkursi shpallet edhe në gjuhët e komuniteteve në komunat ku organizohet mësimi për komunitete.

- Regjistrimi i nxënësve në klasën e dhjetë në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2024/2025

- **Gjimnazi “ Gjergj kastroti Skenderbeu”, Drenas,**

- Drejtimet shkencat natyrore dhe shkencat shoqërore **gjithëseit 300 nxënës,**
- Drejtimi i shkenca natyrore 6 paralele me nga **25 nxënës (150 nxënës)**
- Drejtimi shkenca natyrore 6 paralele me nga **25 nxënës (150 nxënës).**

- **IAAP” Fehmi Lladrovci”, Drenas**

Komuna	Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Drenas	"Fehmi Lladrovci"	Makineri, prodhimtari dhe nderitmar	Instal. i ngrohjes, klimatizim dhe ujesjellesit	2	50
			Komunikacion rrugor	1	25
			Trafik rrugor	1	25
			Automekanik/dual	1	25
			Instalues elektrik	1	25
			Mekatronike	1	25
			Arkitekture	1	25
			Teknik i riciklimit	1	25
			Laborant i kimise	1	25
			Ekonomi, administrim dhe juridik	Kontabilist	1
		Agrokulturë, pylltari, peshkatori dhe veterinari	Banka dhe sigurime	1	25
			Agrobiznes	1	25
			Përpunues i ushqimit dhe profesione të ngjashme	1	25
			Teknologji e Informacionit dhe komunikimit	Telekomunikacion	1
Art	Zhvillues i aplikacioneve sofuerike	2	50		
	Dizajn i tekstilit dhe veshjeve	1	28		
Drenas	"Fehmi Lladrovci"	Shëndeti dhe mirëqenia	Teknik i farmacie	1	28
			Bashkëpunëtor profesional i infermense	1	28
Gjithsej: Drenasi				20	509

Konkursi shpallet bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/1--138, si dhe në Udhëzimin

Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës. Sqarim: Drejtimet për 11 gjimnaze shpallen sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

Kushtet dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP në vitin shkollor 2024-2025, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

3. Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
 - Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
 - Çertifikatën e lindjes
4. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2024-2025, bëhet me datën 10, 11 dhe 12 korrik qershor 2024, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 13.07.2024.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 15.07.2024. Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkollën e dytë behën në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndë prioritare nga shkollimi i obliguar (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100 %), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (Së pari Ilogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksezi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksezi (kl.6+ kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksezi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:

- a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
- b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

- Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- a. Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore, dhe Veterinari:
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- c. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT:
Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- d. Ekonomi, administratë:
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

4. Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimet pörkatöse:

- Gjimnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematike se paku duhet te jete 4 (katör), si dhe 40 % të pikëve nga lëndet prioritare në test (20 pike nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji),
$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes(Bio log fi)} + \text{mes (Fizikë)} + \text{mes(Matematikë)}}{4}$$
- Gjimnaz i shkencave shoqërore dhe gjuhësore - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet te jete 4 (kater) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (40 pike nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)
$$\frac{\text{mes(Gjuhë shqipe)} + \text{mes(Gjuhë angleze)} + \text{mes (Histori)} + \text{mes(Gjeografi)}}{4}$$
- Shkollat e Shëndetësisë - Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).
$$\frac{\text{mes(Kimi)} + \text{mes Bio log ji)} + \text{mes (Fizikë)} + \text{mes(Gjuhë shqipe)}}{4}$$

B. Përmbajtja e testit — numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

1. Gjuhë Shqipe 35 pikë
2. Gjuhë angleze 15 pikë (Gjithsej 50 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 25 pikë
2. Histori 25 pikë (Gjithsej 50 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 35 pikë
2. Informatikë 15 pikë (Gjithsej 50 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 17 pikë
2. Kimi 16 pikë
3. Biologji 17 pikë (Gjithsej 50 pikë)

5. Renditja e lëndëve me përparësi në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

1. Gjinnazi shkencat e natyrës:

1. Shkencat e natyrës - 50	$50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Matematikë dhe Informatikë - 50	$50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50	$50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkencat shoqërore - 50	$50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
	Totali = 40 pikë

II. Gjinnazi shoqëror dhe gjuhësor:

	$50 \times 0.3 = 15$ pikë
I. Shkenca shoqërore - 50	$50 \times 0.3 = 15$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50	$50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë - 50	$50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
4. Shkenca natyrore - 50	

Totali = 40 pikë

6. Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shkencat natyrore - 50
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 50
3. Matematikë dhe Informatikë - 50
4. Shkencat shoqërore - 50

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Komunikacion, Kimi — Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë - 50
2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50
3. Shkenca natyrore - 50
4. Shkenca shoqërore - 50

I
I

I. Ekonomi

Totali • 40 pikë

1. Matematikë dhe Informatikë - 50

2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50
3. Shkenca shoqërore - 50
4. Shkencat natyrore - 50

$50 \times 0.4 = 20$ pikë
 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
 $50 \times 0.4 = 20$ pikë

IV. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 50
2. Shkenca shoqërore - 50
3. Matematikë dhe Informatikë - 50
4. Shkenca natyrore - 50

$50 \times 0.2 = 10$ pikë
 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

$50 \times 0.4 = 20$ pikë

6.

$50 \times 0.2 = 10$ pikë

Totali = 40 pikë

$50 \times 0.15 = 7.5$ pikë

$50 \times 0.05 = 2.5$ pikë

Totali = 40 pikë

Gjeologji, Grafikë dhe

$50 \times 0.4 = 20$ pikë

5. $50 \times 0.2 = 10$ pikë

$50 \times 0.15 = 7.5$ pikë $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

1. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë Gjinnaz, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e Cila merret në shkollë)
- Dëftesën e fotokopjuar për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) , nëse Konkursi shpallet në të njëjtën kohë me shkollat tjera, në të kundërtën origjinalet dhe

-Ekstraktin e lindjes

3. Kriteret për regjistrim

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë — duhet t' i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

- Kandidatët kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.
- Kandidatë do të I nënshtrohen Provimit Pranues.
- Provimi pranues përgatitet, kontrollohet nga mësimdhënës të Autorizuar nga shkolla. • Kandidatët mund të mos i tërheqin dokumentet nga shkollat ku janë pranuar. Mjafton të sjellin dëshmitë e fotokopjuara. (Nëse Konkursi është shpallur në të njëjtën kohë)
- Kandidatët në rangim mund të arrijnë maksimalisht 100 pikë të shpërndara si vijon:
 1. Suksesi i Përgjithshëm nga Shkolla e mesme e ulët 20 pikë (20%);
Për secilën ga klasat 6,7,8,9
 - Për sukses të Shkëlqyeshëm merr nga 5 pikë;
 - Për sukses Shumë të mirë merr nga 4 pikë
 2. Suksesi ng Lënda e Matematikës në Shkollën e mesme të ulët maksimumi 20 pikë.
Për secilën ga klasat 6,7,8,9
 - Për notën 5 në Matematikë merr 5 pikë;
 - Për notën 4 në Matematikë merr 4 pikë;
 3. Suksesi ngaj Testi i arritshmerisë nga lënda e Matematikës, maksimumi 20 pikë;
 4. Suksesi i Provimit pranues —maksimumi 40 pikë.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën 15.07.2024.
Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nukjanë pranuar do të bëhet prej 16.07.2024.

Drenas,
Më:09.07.2024

